

Nr. Prot. 024/B/19

VENDIM Nr. 1338

Për

**Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të draft dokumentit
“Draft Vendimit për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të Roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile me Republikën e Shqipërisë”**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 1), nenit 10, paragrafi 4), neni 64 paragrafi 1), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar |

në mbledhjen e 36-të me radhë të mbajtur më datë 18 Mars 2019, pas shqyrtimit të Rekomandimit të përgatitur nga Grupi Punues (GP) për zbatimin e *“Marrëveshjes për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet Ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”*, vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit **‘Vendimi për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile me Republikën e Shqipërisë’**.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **19 Mars, 2019** dhe përfundon më **15 Prill, 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktivitetëve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Po ashtu neni 9, paragrafi 1 specifikon si në vijim:

“Autoriteti ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikën sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Marrëveshja Shqipëri - Kosovë për roamingun e nënshkruar më datë 26 Nëntor 2018, përcakton ndër të tjera se palët bien dakort që:

- të miratojnë jo më larg se më datën 30 Mars 2019, çfarëdo ndryshimi të ligjeve të tyre të komunikimeve elektronike të domosdoshme për të arritur objektivat e Marrëveshjes (Ref. neni 2 i Marrëveshjes).
- zbatimin e regjimit të ri të fillojë gradualisht nga data 15 Qershor 2019, sipas një plani dhe afateve të rëna dakord ndërmjet Rregullatorëve (Ref. neni 1 i Marrëveshjes);
- zbatimin e kësaj marrëveshje do të koordinohet nga një organ/grup i krijuar nga përfaqësuesit e Rregullatorëve (Ref. neni 5 i Marrëveshjes).

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 19/03/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Zyrës së Zëvendës Kryeministrit z. Fatmir Limaj,
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE),
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK),
- Ofruesve të shërbimeve të telefonisë mobile,
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.